

VENDIM
Nr.1029, datë 8.10.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“HYRJA KAVAJË-UNAZË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Hyrja Kavajë-Unazë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1071.5 (një mijë e shtatëdhjetë e një pikë pesë) m², tokë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 16 072 500 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 277 000 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 16 072 500 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2009 dhe të përfundojë më 15.1.2010.
 7. Pronarët, për të cilët, në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS “HYRJA E KAVAJËS-UNAZË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Nr.pas	Sipërf. përgjith. m2	LLOJI I PASURISË						Shuma në lekë	Shënime
							TRUALL			ARË				
							m2	çmimi	vl.lekë	m2	çmimi	vl.lekë		
1	Nikolla	Mihal	Hotova	8551	1/179,180	1000	82	15000	1230000				1230000	Konf.ZVRPP
2	Lutfi	Jonuz	Veipi	8551	1/237	1150	180	15000	2700000				2700000	Konf.ZVRPP
3	Meleqe	Ali	Tallushi	8551	1/98	600	56	15000	840000				840000	Konf.ZVRPP
4	Bashkëpronarët		Galica	8551	1/274	2931	280	15000	4200000				4200000	Konf.ZVRPP
5	Zyhdi	Rrahman	Teferici	8551	1/230	290	78.5	15000	1177500				1177500	Konf.ZVRPP
6	Hasan	Rrahman	Teferici	8551	1/158	1170	40	15000	600000				600000	Konf.ZVRPP
7	Xhavit	Sulejman	Hyka	8551	1/161	600	68	15000	1020000				1020000	Konf.ZVRPP
8	Lavdërim		Lusha	8551	1/99	1165	67	15000	1005000				1005000	Konf.ZVRPP
9	Pronar i papërcaktuar			8551	1/158		35	15000	525000				525000	Konf.ZVRPP
10	Bashkëpronarët		Qarri	8551	1/166	2000	80	15000	1200000				1200000	Konf.ZVRPP
11	Enver		Tallushi	8551	1/168	1000	37	15000	555000				555000	Konf.ZVRPP
12	Shpresa		Kacbufi	8551	1/162	2000	68	15000	1020000				1020000	Konf.ZVRPP
	Shuma						1071.5		16072500				16072500	

Pasuria 1/274 dhe 1/158 janë konfirmuar nga ZVRPP Kavajë me komentin që këto prona janë në proces gjyqësor.

Pasuria 1/230 konfirmuar nga ZVRPP Kavajë. Bllokuar në favor të Bankës Popullore me kontratën nr.2956/1246/1 datë 25.9.9.2008.

Pasuria 1/99 konfirmuar nga ZVRPP Kavajë. Bllokuar në favor të Bankës Popullore me kontratën nr.5367/1069/1, datë 28.6.2006

